

**Një pagë jetese për  
punëtorët në Kosovë:  
Përpjekja për një  
jetesë bazike por të  
dinjitetshme**



2024



**Një pagë jetese për  
punëtorët në Kosovë:  
Përpjekja për një  
jetesë bazike por të  
dinjitetshme**



**Instituti për Politika Sociale 'Musine Kokalari'** është një institut i pavarur i krijuar si think tank, i cili bën promovimin e vlerave social-demokrate në Kosovë duke ndihmuar organizatat shoqërore e progresive që të krijojnë, zbatojnë dhe promovojnë politikat e tyre. Ne përqëndrohemi në konceptimin dhe promovimin e një shoqërie të drejtë, të barabartë dhe ligjore. Duke u përqëndruar në të ardhmen, ne përpiqemi të kapërcejmë dallimet duke ngushtuar boshllëqet dhe duke krijuar vlera të përbashkëta publike, të ndara nga të gjithë dhe të vlerësuara kolektivisht.

**"Një pagë jetese për punëtorët në Kosovë: Përpjekja për një jetesë bazike por të dinjitetshme"** është një publikim i cili ofron vlerësimet e para të pagës së jetesës në Kosovë, duke llogaritur variacionet në kostot rajonale dhe tatimet. Duke vlerësuar boshllëqet midis pagave aktuale dhe pagës së vlerësuar të jetesës, publikimi informon palët e interesuara dhe politikëbërësit për mjaftueshmërinë e të ardhurave të punëtorëve për të mbuluar shpenzimet bazë të jetesës, duke adresuar kështu shqetësimet rreth varfërisë.

**Mohim përgjegjësie:** Ky raport është zhvilluar në kuadër të projektit HumanRightivism, i mbështetur nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë përmes Fondit për Zhvillim të Komunitetit – CDF. Këtë material /prodhim e ka financuar Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar - Sida. Përgjegjësia për përmbajtjen i takon tërësisht IPS Musine Kokalari dhe autorit Edison Jakurti. SIDA nuk ndan domosdoshmërisht pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

**E drejta e autorit © 2024** i përket IPS Musine Kokalari dhe autorit Edison Jakurti. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet ose transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mënyre (elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese ose ndryshe) pa pëlqimin paraprak me shkrim të IPS Musine Kokalari dhe autorit Edison Jakurti.

Versioni original i këtij raporti është shkruar në gjuhën angleze.

**Autor: Edison Jakurti**

Edison Jakurti është doktorant i shkencave ekonomike në Universitetin Leipzig dhe ligjërues në Lancaster University. Studimet e nivelit master i ka kryer për politikat e zhvillimit ndërkombëtar, me fokus në ekonomiksën aplikativ, në Duke University, dhe studimet themelore në drejtimin ekonomik dhe statistikë në Rochester Institute of Technology. Më herët ka punuar si asistent hulumtues dhe asistent ligjërues në Duke University.



Adresa: Rruga B, Residio (Dervisholli),  
Hyrja B, Nr. 15, 10 000 Prishtinë, Kosovë  
Kontakti: +383 44 752 353  
info@musineinstitute.org  
www.musineinstitute.org

# Përmbajtja:

1. Hyrje	07
2. Çka është paga e jetesës?	08
3. Burimet e të dhënave dhe definicionet	11
4. Metodologjia	14
5. Vlerësimet e pagës së jetesës në Kosovë	19
6. Përfundimi	32
Bibliografia	33
Shtojca A	34



# 1. Hyrje

Për shumicën e punëtorëve në botë, të ardhurat nga puna në formën e pagës janë i vetmi burim i të ardhurave. Si të tilla, pagat nuk janë vetëm ndër komponentët kryesorë të tregut të punës, por edhe mbase përcaktuesi kryesor i standartit të jetesës së punëtorëve dhe familjeve të tyre. Shuma që punëtorët fitojnë jo vetëm që ndikon në kushtet e tyre të tanishme, por gjithashtu edhe në mundësitë që fëmijët e tyre të kenë një jetë të dinjitetshme në të ardhmen. Prandaj, është e domosdoshme që punëtorëve tu paguhet një pagë jetese që mbulon shpenzimet e një jetese bazë por të dinjitetshme, duke i parandaluar kështu ata dhe familjet e tyre të bien në varfëri.

Në këtë hulumtim, sipas njohurive tona, ne kemi bërë përlogaritjet e para të një page jetese në Kosovë. Duke ndjekur në vija të gjera metodologjinë e propozuar nga Anker dhe Anker (2017), kemi përlogaritur shpenzimet e jetesës për një familje të përbërë nga dy të rritur dhe dy fëmijë, ku vetëm njëri nga të rriturit punon me orar të plotë. Duke njohur preferencat heterogjene dhe ndryshimet në ofertë dhe kërkesë, ne kemi marrë parasysh dallimet që rajonet e ndryshme kanë në çmime dhe kemi përlogaritur pagën për zona urbane dhe rurale. Gjithashtu, kemi marrë parasysh zbritjet nga paga si tatimi mbi të ardhurat dhe kontributet pensionale, në mënyrë që ta paraqesim pagën e jetesës në vlerë bruto. Në fund, i kemi llogaritur hendeqet mes pagës minimale, dhe pagave të tjera ekzistuese, dhe pagës së jetesës që ne e kemi përlogaritur. Në këtë proces, kemi marrë parasysh dallimet mes sektorit publik dhe privat, sektorëve të ndryshëm në bazë të aktivitetit ekonomik, gjinive dhe grupmoshave. Këto rezultate mund t'i informojnë palët e ndryshme të interesit dhe politikëbërësit në lidhje më atë se në deri çfarë mase pagat aktuale i mbulojnë shpenzimet e jetesës për punëtorët.

## 2. Çka është paga e jetesës?

### 2.1 Përcaktimi i pagës së jetesës

Paga e jetesës nuk është koncept i ri. Edhe pse mund të ketë ekzistuar si koncept që nga Greqia e lashtë, mund ta hasim lehtësisht në shumë tekste moderne që nga *Pasuria e Kombeve* e Adam Smith-it deri te disa kushtetuta të shteteve të ndryshme sot (Anker, 2011). Preambula e Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës thekson rëndësinë e “sigurimit të një page jetese adekuate” (ONP, 1919), ndërsa neni 23 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara pohon se “të gjithë ata që punojnë e kanë të drejtën për një pagë të drejtë dhe të favorshme që i siguron vetes dhe familjes një ekzistencë me dinjitet njerëzor” (Kombet e Bashkuara, 1948).

Duke përmbledhur konkluzionet nga Anker (2011), Anker dhe Anker (2017) theksojnë përkufizimin e një page jetese:

(i) është një e drejtë sipas komunitetit ndërkombëtar; (ii) duhet të jetë e mjaftueshme për ta siguruar një standart jetese bazik, por të dinjitetshëm, që është i përshtatshëm për një kohë dhe vend të caktuar dhe që përmirësohet me zhvillimin ekonomik; (iii) duhet të jetë e mjaftueshme për të mbajtur një familje; (iv) duhet t'i përfshijë tatimet mbi pagën dhe të ardhurat në mënyrë që paga neto pas tatimeve të jetë e mjaftueshme; dhe (v) duhet të fitohet gjatë orarit të punës dhe të mos kërkojë punë shtesë përtej këtij orari (Anker dhe Anker, 2017, f.8).

Si e tillë, paga e jetesës llogaritet me bazë normative dhe kryesisht ka të bëjë me nevojat e punëtorëve/eve dhe familjeve të tyre. Ndryshe nga paga minimale, e cila në shumë vende është kërkesë ligjore ku qeveritë marrin parasysh faktorë të tjerë ekonomikë si niveli i zhvillimit ekonomik, produktiviteti i punës, dhe punësimi, paga e jetesës është zakonisht vullnetare (Anker dhe Anker, 2017). Megjithatë, duhet pranuar që në fillim se, me gjithë rigorozitetin dhe arsyetimin metodologjik, përlllogaritjet e pagës së jetesës bëhen përmes një doze të konsiderueshme subjektiviteti.

Anker (2011) ofron një rishikim të detajuar të literaturës dhe një analizë të thuktë të metodologjive të ndryshme të përdorura për përlllogaritjen e pagës së jetesës. Guzi dhe Kahanec (2018) tregojnë më shumë shembuj të studimeve dhe fushatave të tjera për një pagë jetese dhe japin vlerësime për 58 vende të botës. Në një studim të botuar më rishtazi, Guzi (2021) vlerëson pagat e jetesës për anëtarët e Bashkimit Evropian. Ekzistojnë dy tipare të përbashkëta në këto studime. Së pari, ata ndjekin gjerësisht metodologjinë e propozuar në Anker dhe Anker (2017). Së dyti, asnjëra prej tyre nuk e përfshin Kosovën. Prandaj, në këtë studim synojmë të plotësojmë këtë zbrazëti në literaturë duke ofruar përpjekjen e parë për përlllogaritjen e një pagë të jetesës në Kosovë.


### 2.2 Rëndësia për politikëbërje

Ndër qëllimet kryesore të përlllogaritjes së pagës së jetesës është përcaktimi i hendeqeve midis pagës së jetesës dhe pagave ekzistuese në ekonomi (Anker dhe Anker, 2017). Këto hendeqe më pas informojnë palët të interesit dhe politikëbërësit të ndryshëm në lidhje me atë se deri në çfarë mase pagat aktuale janë të mjaftueshme për të mbuluar koston e jetesës së punëtorëve. Figura 1 tregon katër palët kryesore të interesit dhe politikës apo instrumentet e tyre që mund të përfitojnë nga paga që ne kemi llogaritur.



Figura 01

Palët e interesit që përfitojnë nga përllogaritja e pagës së jetesës në Kosovë



Në mënyrë të veçantë, hendeku midis pagave të tjera dhe pagës së jetesës mund të informojë:

- (i) **Qeverinë**, në lidhje me masën në të cilën paga minimale mund të konsiderohet një pagë jetese. Anker dhe Anker (2017) theksojnë që kur qeveritë përcaktojnë pagën minimale, përveç mirëqenies së punëtorëve, ato duhet të marrin parasysh edhe faktorë të tjerë ekonomikë, si produktivitetin, normat e punësimit, rritjen e përgjithshme ekonomike, etj. Megjithatë, nga viti 2011 deri në vitin 2023, paga minimale në Kosovë nuk ka ndryshuar. Për më shumë se një dekadë, ajo ka mbetur €130 për punëtorët nën 35 vjeç dhe €170 për ata mbi 35 vjeç. Në 2023, qeveria miratoi një ligj që rrit pagën minimale në €264, por aktualisht është duke u shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese pas apelimit të partive opozitare. Pavarësisht nga rezultati, paga minimale duhet të rritet dhe, si përllogaritjet e pagës së jetesës, të përditësohet periodikisht. Në këtë proces, hendeku mes pagës minimale të propozuar dhe pagës sonë të përllogaritur të jetesës shërben si kontrollë për përshtatshmërinë e nivelit të pagës minimale të propozuar.
- (ii) **Bizneset**, në lidhje me masën që pagat që ua paguajnë punëtorëve të tyre, në sektorët dhe industritë e tyre të veçanta, janë të mjaftueshme për një jetë bazë, por të dinjitetshme. Mund të thuhet që ankesa kryesore e bizneseve në Kosovë sot është oferta e ulët e fuqisë punëtore, kryesisht për shkak të prirjes së

punëtorëve për të emigruar. Duke pasur parasysh liberalizimin e vizave nga 1 janari, kjo mund të bëhet edhe më shqetësuese. Në një studim të kryer në dhjetor 2023, Instituti GAP gjeti se rreth 28% e qytetarëve mbi 18 vjeç planifikojnë të emigrojnë në tremujorin e parë të vitit 2024 (GAP, 2024, f.11). Megjithatë, "pagat më të mira" duket se janë faktori kryesor (32.4%) që do t'i dekurajonte ata nga emigrimi, ndjekur nga "përmirësimi i kushteve të punës, si respektimi i kontratës së punës, orari i punës, pushimi vjetor e të ngjashme" (29.2%) (GAP, 2024, f.16). Kështu, hendeuku midis pagave në sektorë të ndryshëm ekonomikë dhe pagës sonë të përlloritur të jetesës mund të japë përmasa më të sakta për rritjen e pagave në sektorin privat.

- (iii) **Sindikatat**, lidhur me potencialin për tu mobilizuar rreth një kauze për rritjen e pagave në sektorë të ndryshëm. Përderisa sindikatat në sektorin publik mbeten një aktor relevant në tregun e punës në Kosovë, me shumë pak përjashtime, praktikisht nuk ka sindikata në sektorin privat. Kështu, hendeuku midis pagave aktuale dhe pagës sonë të përlloritur të jetesës mund të shërbejë për dy qëllime. Së pari, mund t'i ndihmojë sindikatat në sektorin publik që të dizajnojnë kërkesa të bazura në hulumtime për rritjen e pagave. Neumark (2004) tregon se ligjet e pagave të jetesës rrisin fuqinë negociuese të punëtorëve të sindikalizuar. Gjithashtu, Kerrissey dhe Meyers (2021) konstatojnë se mekanizmat e sindikatave mund të kenë një efekt të barazisë në hendekun gjinor të pagave, gjë që analiza jonë e ilustron si problem në Kosovë. Së dyti, mund të ndihmojë punëtorët në sektorin privat të mobilizohen rreth një kauze që mund të çojë potencialisht në formimin e sindikatave në disa industri.<sup>1</sup>
- (iv) **OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare**, të interesuara për të drejtat e punëtorëve dhe kushtet e punës, në lidhje me shkallën e rrezikut që punëtorët të bien në varfëri. Hendeqet midis pagave tjera aktuale dhe pagës së jetesës mund të informojnë propozimet e tyre të politikave, duke synuar kështu më mirë çrënjosjen e varfërisë (në punë) dhe duke përmirësuar mirëqenien e punëtorëve.

---

<sup>1</sup> Ndërsa pranojmë një mori vështirësish në këtë proces, kujtojmë shembuj të tillë si lëvizja "Occupy" e cila buroi nga pakënaqësia me politika të austeritetit pas recesionit të madh, rritjen e pabarazisë në të ardhura dhe pasuri, etj. Për shembull, slogani i tyre kryesor ishte "Ne jemi 99%" që mund të pikaset në punën e ekonomistëve si Joseph Stiglitz, i cili kishte vënë në dukje rritjen e pabarazive mes 1%-shit me të ardhurat më të larta e dhe pjesës tjetër të popullsisë.

## 3. Burimet e të dhënave dhe definicionet

Duke ndjekur në vija të gjera Anker dhe Anker (2017), shumica e përlllogaritjeve tona për pagën e jetesës në Kosovë bazohen në shpenzimet e ekonomive familjare. Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) e vitit 2022, e cila është realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), është burimi kryesor i të dhënave që ne kemi përdorur në këtë studim. Si praktikë standarte ndërkombëtare, ABEF përmban të dhëna për shpenzimet e ekonomive familjare të strukturuar përmes klasifikimit ndërkombëtar të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP), i cili përbëhet nga 12 kategori kryesore. Për dy kategoritë e para, ABEF përfshin pyetje mbi artikujt dhe çmimet e blerjeve të bëra gjatë 2 javëve të fundit. Ne i kemi shumëzuar këto vlera me 2 për të llogaritur shpenzimet mujore. Për 10 kategoritë e ardhshme, ekonomitë familjare janë pyetur për shpenzimet e tyre gjatë 3 respektivisht 12 muajve të fundit. Ne i kemi pjesëtuar këto vlera për 3 respektivisht 12 në mënyrë që t'i llogarisim shpenzimet mujore.

Për secilën kategori, e kemi përdorur Indeksin e Çmimeve të Konsumit nga ASK, për vitin 2023, janar 2024 dhe shkurt 2024, për t'i konvertuar vlerat e ABEF në çmimet e vitit 2024. Për kategori të caktuara, siç specifikohet më poshtë, kemi përdorur informacione nga ndërmarrjet publike si Telekom i Kosovës dhe Trafiku Urban.

Për të përcaktuar numrin e punëtorëve ekuivalent me orar të plotë për familje, i kemi përdorur të dhënat nga ASK për shkallën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, shkallën e papunësisë dhe përqindjen e punëtorëve që punojnë me orar të plotë. Për llogaritjen e hendeqeve në paga, i kemi marrë të dhënat për numrin e të punësuarve, medianën e pagave dhe pagën mesatare sipas gjinisë, grupmoshës, llojit të ndërmarrjes dhe aktiviteteve ekonomike, nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Më poshtë tregojmë se çfarë përfshin në përgjithësi çdo kategori shpenzimesh.<sup>2</sup>

### 3.1 Kostot e ushqimit dhe pijeve

Ushqimet dhe pijet përbëjnë një nga kategoritë më të rëndësishme të shpenzimeve për familjet. Kategoria “Ushqimi dhe pijet joalkoolike” përbëhet nga artikujt të tillë si buka dhe produktet e furrës, mishi, peshku dhe ushqimet e tjera të detit, qumështi, vezët, djathi, vajrat dhe yndyrat, frutat, perimet, sheqeri, pastičeritë dhe ëmbëlsirat, kripa, salcat, erëzat, çaji, kafeja, pijet joalkoolike, etj. Ne e kemi kombinuar këtë kategori me kategorinë “Pijet alkoolike dhe duhani” në një.

### 3.2 Shpenzimet për veshmbathje

Veshëmbathjet përfshijnë artikujt të tillë si veshje për burra, gra dhe fëmijë (0-13 vjeç) dhe këpucë për secilin nga grupet e lartpërmendura.

<sup>2</sup> Shih ASK (2023b) për të gjithë listën e të gjithë artikujve të përfshirë për secilën kategori.

### 3.3 Kostot e banimit

ABEF përfshin artikuj nga kategoria “Banimi, uji, rryma, gazi dhe lëndë djegëse të tjera” që është një përbërës tjetër kryesor në shpenzimet e ekonomive familjare. Kjo kategori përfshin qerata dhe qerata e imputuara, materialet për mirëmbajtjen dhe riparimin e banesës, shpenzimet për ujësjellës, energji elektrike, gaz, lëndë djegëse druri, etj. Duhet të theksohet se 97.5% e familjeve në ABEF raportojnë se e kanë në pronësi shtëpinë ku jetojnë. Megjithatë, ne i kemi përfshirë qerata dhe qerata e imputuara në këtë kategori.

### 3.4 Mirëmbajtja e shtëpisë

Mirëmbajtja e shtëpisë është e domosdoshme, ndaj ne i kemi përfshirë edhe këto shpenzime. ABEF përfshin artikuj nga kategoria “Mobiliet, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtja e shtëpisë” që përbëhet nga shpenzimet si blerja e mobiljeve, mobilimi dhe qilimat, tekstilet shtëpiake, pajisjet elektroshtëpiake, enët e qelqit, mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen rutinore të shtëpisë, etj.

### 3.5 Shpenzimet shëndetësore

Kategoria “Shëndetësia” përfshin një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh të lidhura me shëndetin, duke përfshirë barnat dhe produktet shëndetësore, shërbimet e kujdesit ambulator, shërbimet e kujdesit spitalor, etj. Në analizën tonë, ne kemi supozuar që punëtorët përdorin kryesisht shërbimet e kujdesit shëndetësor publik dhe se shpenzimet e tyre kryesore shëndetësore janë për barnat që nuk ofrohen nga institucionet publike shëndetësore.

### 3.6 Kostot e transportit

Ne kemi supozuar se punëtorët kryesisht përdorin transportin publik për të shkuar në punë dhe për të kryer aktivitetet e tyre të përditshme, si blerja e ushqimeve. Prandaj, kemi përdorur çmimet e biletave të transportit publik siç janë ato të ofruara nga Trafiku Urban në Prishtinë.<sup>3</sup> Kostot i kemi përshtatur duke pasur parasysh që: 1) jo të gjitha zonat urbane ofrojnë transport publik dhe b) disa punëtorë, si për shembull ata që jetojnë në zona periferike ose rurale, mund të udhëtojnë distanca më të gjata që shkojnë përtej hartës së mbuluar nga transporti urban. Prandaj, kemi supozuar se kostot e transportit sillen rreth €2 për çdo ditë pune.

### 3.7 Kostot e komunikimit

Të gjitha familjet në ABEF raportojnë se kanë telefona celularë, kështu që ne i kemi marrë parasysh edhe shpenzimet e komunikimit. Kemi supozuar përdorimin e pakos Fol M të ofruar nga ndërmarrja publike Kosova Telecom për €4.99.<sup>4</sup> Kjo paketë përfshin 300 minuta telefonatë, 300 SMS dhe 4 GB data interneti në muaj. Për më tepër, lidhja me internetin në shtëpi sot është normë, ndaj i kemi përfshirë edhe këto shpenzime. Kemi supozuar blerjen e shërbimit të internetit dhe programeve të TV-së më bazik nga ofruesi publik Telekom i Kosovës. Konkretisht, kemi supozuar blerjen e pakos TV Vala Start, e cila përfshin lidhjen në internet, kanalet televizive dhe shërbimet e telefonisë fikse për €15.99 në muaj.<sup>5</sup>

3 Sipas Trafikut Urban (2024), çmimi për një udhëtim është €0,50 ndërsa për një biletë mujore është €14. Për nxënës dhe studentë, çmimi i zbritur për një biletë mujore është €14.

4 Shih Telekom i Kosovës (2024).

5 Shih Telekom i Kosovës (2024).

### 3.8 Aktivitete rekreative dhe kulturore

Punëtorët jo vetëm që duhet të kenë një dietë dhe strehim të përshtatshëm, por duhet të kenë mundësi të marrin pjesë edhe në aktivitete rekreative dhe kulturore në kohën e tyre të lirë. Ne kemi supozuar që, një herë në javë, punëtorët dhe familjet e tyre ndjekin një ndeshje sportive, shikojnë një shfaqje në teatër ose film në kinema, ose marrin pjesë në ndonjë ngjarje tjetër sociale për të cilën shpenzojnë mesatarisht €4 për person.<sup>6</sup>

### 3.9 Shpenzimet për arsim

Ne kemi përdorur të dhëna për shpenzimet për arsim nga ABEF. Kjo kategori përfshin artikuj të tillë si kurset e gjuhëve të huaja dhe aftësive kompjuterike, transportin shkollor, mjetet shkollore, ushqimin në shkollë, etj. Kemi supozuar se nxënësit shkojnë në shkollë në këmbë dhe duke qenë se arsimi publik është falas, shumica e shpenzimeve të arsimit janë për mjete shkollore që nuk ofrohen nga institucionet arsimore publike, kurse jashtëshkollore (p.sh., gjuhë të huaj, aftësi kompjuterike, programim, etj.) dhe ushqim në shkollë.

### 3.10 Restorantet dhe hotelet

Ndërsa kemi supozuar se punëtori/ja dhe familja e tij/saj blejnë produkte ushqimore dhe hanë brenda, ata duhet të gëzojnë të drejtën të hanë edhe jashtë. Gjithashtu, si një normë kulturore, shumica e punëtorëve në Kosovë dalin për kafe gjatë pushimit të punës. Prandaj, kemi supozuar se një punëtor shpenzon mesatarisht €1 gjatë pushimit nga puna (p.sh. për kafe, çaj, etj.). Për më tepër, edhe pse kjo nuk bëhet çdo ditë, kemi supozuar që punëtori/ja apo ndonjë nga anëtarët e familjes së tij/saj shpenzojnë mesatarisht €6 sa herë që ata hanë jashtë.

### 3.11 Mallrat dhe shërbimet e ndryshme

Kjo kategori ka shpenzime të ndryshme për mallra dhe shërbime, që nuk përfshihen në kategori të tjera, por që ne i marrim parasysh. Për shembull, produktet për kujdesin personal (p.sh., rroje elektrike ose jo elektrike, etj.) dhe shërbime të tilla si prerja e flokëve, rrobaqepësia, etj., bëjnë pjesë në këtë kategori. Për shpenzime të tilla i kemi përdorur të dhënat nga ABEF.

---

<sup>6</sup> Për shembull, biletat për një ndeshje tipike futbollit ose basketbollit kushtojnë €2-3 euro për person, €3 euro për një shfaqje të zakonshme në teatër (p.sh. Teatri Kombëtar i Kosovës, Teatri Dodona, Teatri i Gjakovës, etj.), për një film të zakonshëm në kinema rreth €3-6 (p.sh. Cineplexx, Kino ABC, Kino Hyrije Hana, etj.).

## 4. Metodologjia

### 4.1 Përcaktimi i madhësisë së familjes

Bazuar në një rishikim të thuktë të punimeve për përcaktimin e pagës së jetesës në vende të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme të zhvillimit, Anker (2011) arrin në përfundimin se “paga e jetesës është një koncept familjar. Një punëtor/e duhet të jetë në gjendje të mbajë një familje me një pagë jetese” (f. 49). Duke qenë se ka definime të ndryshme të familjes, Anker dhe Anker (2017) sugjerojnë përdorimin e atij të familjes së ngushtë të një punëtori/-eje, i cili përfshin bashkëshortin/-en/partnerin/-en e tij/saj dhe fëmijët dhe përjashton prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes së gjerë. Ne e kemi përdorur këtë përkufizim të familjes për të përcaktuar familjen tonë referuese.

Hapi i dytë i rëndësishëm është përcaktimi i madhësisë së familjes. Kjo është thelbësore sepse ndikon në kostot dhe si pasojë në nivelin e pagës së jetesës që mundëson një jetë të denjë për punëtorin/-en dhe familjen e tij/saj. Anker dhe Anker (2017) sugjerojnë tre mënyra për të përcaktuar madhësinë e familjes: (i) numrin e fëmijëve të lindur për grua, (ii) madhësinë mesatare të ekonomisë familjare dhe (iii) një madhësi tipike të familjes - shpesh katër anëtarë (Anker, 2011).

Ne kemi përdorur dy qasjet e para për t'i krahasuar me të tretën – e një madhësi tipike të familjes prej 4 anëtarësh. Në 2021, që është viti me të dhënat më të fundit, shkalla totale e fertilitetit (ShTF) në Kosovë ishte 1.52 (Banka Botërore, 2024). Anker dhe Anker (2017) sugjerojnë që ky numër duhet të përshtatet për shkallën e vdekshmërisë së fëmijëve dhe propozojnë që numri mesatar i fëmijëve të mbijetuar të jetë produkt i ShTF, dhe 1 minus norma e vdekshmërisë së fëmijëve për 100 lindje. Në 2021, shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç (për 1,000 lindje të gjalla) ishte 10 (Banka Botërore, 2024). Duke përdorur qasjen e adaptimit të propozuar nga Anker dhe Anker (2017), ne kemi përcaktuar se numri mesatar i fëmijëve të mbijetuar është 1.5. Kështu, bazuar në këtë qasje, madhësia e familjes referuese do të ishte 4 – 2 prindërit dhe 2 fëmijë.

Qasja e dytë do të ishte përdorimi i mesatares së anëtarëve për ekonomi familjare. Duhet të theksohet se ekonomia familjare/amvisëria dhe familja nuk janë sinonime. Ekonomia familjare/amvisëria mund të përbëhet nga një ose më shumë njerëz që thjesht ndajnë “ushqim, strehim dhe gjëra të tjera thelbësore për të jetuar” (Bongaarts, 2001, f. 263-264).<sup>7</sup> Ndërsa familja, e cila siç u shpjegua më herët shpesh përkufizohet ndryshe, i referohet më shumë një grupi të të afërmeve, të cilët janë të lidhur me njëri-tjetrin nga gjaku ose martesë (Bongaarts, 2001).

Megjithatë, ne e kemi testuar këtë qasje duke përdorur të dhëna nga ABEF mbi ekonomitë familjare dhe jo nga familjet. Mesatarja e numrit të anëtarëve në mostrën e pakufizuar të ekonomive familjare në ABEF është 4.3. Anker dhe Anker (2017) sugjerojnë që, kur përdoret kjo qasje, mostra e ekonomive familjare duhet të përjashtojë familjet me një person dhe veçanërisht familjet e mëdha, të cilat ata i përcaktojnë si ShTF plus 5. Në rastin tonë, kur përjashtojmë familjet e përbëra me vetëm një person dhe ato me 8 anëtarë ose më shumë, numri i anëtarëve për ekonomi familjare del të jetë 4.15.

Prandaj, ne e kemi përdorur një madhësi familjare prej 4 anëtarësh, e cila duket të jetë e arsyeshme në kontekstin e Kosovës dhe e qëndrueshme ndaj qasjeve të ndryshme për përcaktimin e madhësisë së familjes. Ne e kemi përcaktuar familjen tonë referuese që të përfshijë 2 të rritur dhe 2 fëmijë nën 18 vjeç, dhe sipas Guzi (2021) e quajmë “familje standarte”.

<sup>7</sup> Pra, një ekonomi familjare/amvisëri mund të përbëhet nga më shumë familje, për shembull.

## 4.2 Përcaktimi i ekuivalentit të punëtorëve me orar të plotë

Për shkak se paga e jetesës është një koncept familjar, është e arsyeshme të pritet që më shumë se një anëtar i familjes të jetë në marrëdhënie pune. Si e tillë, kostoja e një standardi të mirë jetese për të gjithë familjen ndahet me ekuivalentën e punëtorëve me orar të plotë në familje. Duke qenë se ne përjashtojmë mundësinë e punës së fëmijëve, sepse e konsiderojmë atë të papranueshme moralisht dhe etikisht, në familjen tonë referuese prej 4 anëtarësh prej 2 të rriturve dhe 2 fëmijëve, ne mund të kemi 1 ose 2 punëtorë ekuivalent me orar të plotë.

Përderisa Anker (2011) tregon se supozimet për 1 ose 2 punëtorë janë norma më të shpeshta në studime, Anker dhe Anker (2017) sugjerojnë se ky nuk është një supozim real dhe as i arsyeshëm në botën e sotme. Supozimi i 1 punëtori për familje mund të ishte i arsyeshëm në të kaluarën, ku kreu i familjes, zakonisht burri, pritej të ishte i vetmi mbajtës i familjes së tij, por sot gratë po ashtu janë në marrëdhënie pune (Anker dhe Anker, 2017). Gjithashtu, supozimi i 2 punëtorëve për familje mund të jetë pa bazë sepse shumë punëtorë e kanë të vështirë të gjejnë punë me orar të plotë ose sepse disa punëtorë (zakonisht gratë) duhet të ndajnë kohën për punën e kujdesit në shtëpi (Anker dhe Anker, 2017).<sup>8</sup>

Për të shmangur këto vështirësi, Anker dhe Anker (2017) sugjerojnë që duhet të merren parasysh tregues specifikë të kontekstit, siç janë shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (ShPFP), shkalla e papunësisë dhe shkalla e punësimit me kohë të pjesshme. Ata propozojnë qasjen e mëposhtme që konsiston në dy hapa. Në hapin e parë, llogaritet përqindja e ekuivalentit me orar të plotë për punëtorët në moshë pune, e përcaktuar si

$$\text{Proportioni i ekuivalentit me orar të plotë për të rriturit në moshë pune} = \text{ShPFP për të rriturin mesatar} \times (1 - \text{shkalla e papunësisë}) \times (1 - [\text{shkalla e punësimit të pjesshëm} \div 2])$$

Në hapin e dytë, me supozimin se të paktën 1 punëtor/e ka një punë me orar të plotë gjatë gjithë vitit, duke shtuar 1 në proporcionin e definuar në hapin e parë mund të përcaktohet numri i punëtorëve ekuivalent me orar të plotë. Për shkak të niveleve më të larta të papunësisë tek të rinjtë, Anker dhe Anker (2017) sugjerojnë që moshat 18-24 vjeç duhet të mos përfshihen dhe se ShPFP dhe normat e papunësisë duhet të jenë nga grupmosha 25-59 vjeç.

Ne kemi ndjekur këtë qasje për përcaktimin e numrit të punëtorëve ekuivalent me orar të plotë për familjen tonë referuese. Kemi përdorur Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) për tremujorin e parë të vitit 2023 sepse ky është versioni më i fundit i publikuar nga ASK-ja. Duke pasur parasysh strukturën e të dhënave të disponueshme, kemi përcaktuar ShPFP dhe normat e papunësisë për moshat 25-64 vjeç dhe kemi përdorur normën e punësimit me orar të pjesshëm për të gjithë punëtorët. Bazuar në këtë qasje, numri ekuivalent i punëtorëve me orar të plotë del të jetë 1.4. Me fjalë të tjera, kjo supozon se një nga të rriturit do të punonte me orar të plotë, ndërsa partneri i tij ose i saj do të punonte 2 ditë në javë. Megjithatë, për shkak se nuk i kemi të dhënat më të fundit, ne kemi ndjekur një qasje më optimiste dhe kemi supozuar se punëtori i dytë punon 3 ditë në javë.<sup>9</sup> Pra, ne kemi përcaktuar numrin e punonjësve ekuivalent me orar të plotë për familjen tonë referuese që të jetë 1.6.

<sup>8</sup> Në tremujorin e parë të vitit 2023, 52.3% e punonjësve me orar të pjesshëm thanë se punojnë pjesërisht sepse nuk mund të gjejnë një punë me orar të plotë (ASK, 2024, f. 20). Për më tepër, Drevinja dhe Ymeri (2022) theksojnë se gratë në Kosovë shpenzojnë 2.7 orë ose 44% më shumë kohë mesatarisht në punë të kujdesit të papaguar krahasuar me burrat (f. 15).

<sup>9</sup> Ky është një supozim i besueshëm meqenëse mes tremujorit të parë të 2023 dhe 2022, ShPFP e përgjithshme u rrit nga 38.6 në 39.5%, ndërsa shkalla e përgjithshme e papunësisë ra nga 16.6 në 11.5% (KAS, 2024, 2023). Për më tepër, Guzi (2021) supozon që numri i punëtorëve ekuivalent me orar të plotë për EU-27 të jetë 1.8.

### 4.3 Përlllogaritja e kostos së jetesës

Ne kemi ndjekur në vija të gjera metodologjinë e propozuar në Anker dhe Anker (2017) për përlllogaritjen e pagës së jetesës. Në Sektorin 3 shpjegojmë se si përkufizohet secila kategori e shpenzimeve të ekonomive familjare në ABEF dhe përshkruam supozimet që kemi bërë. Tabela 1 tregon mënyrën e detajuar për llogaritjen e shpenzimeve në secilën kategori. Duke përdorur të dhënat nga ABEF, bazuar në përkufizimin tonë të familjes referuese, ne e kemi kufizuar mostrën tonë në familjet me vetëm dy punëtorë, pra bashkëshortë/partnerë dhe dy fëmijë. Mostra jonë përbëhet nga 107 familje me 428 anëtarë, që është rreth 8% e mostrës totale në ABEF.

Së pari kemi llogaritur shpenzimet familjare për secilën kategori. Më pas, e kemi ndarë shumën totale të shpenzimeve familjare me 1.6 për të mbërritur te shpenzimet për vetëm një punëtor/e. Siç shpjegohet në Tabelën 1, ndërsa shumata e përgjithshme mbetet konstante, ne kemi lejuar që shpenzimet në disa kategori të variojnë.

Tabela 01

Llogaritjet e shpenzimeve për secilën kategori

Kategoria	Familja standarte	Një punëtor/e
<b>Ushqimi dhe pijet</b>	Shpenzimet janë të raportuara për familje në 25 përqindëshin e shpërndarjes së shpenzimeve në këtë kategori. <sup>10</sup>	Shpenzimet familjare të ndara për 1.5. <sup>11</sup>
<b>Veshmbathja</b>	Gjysma e shpenzimeve të familjeve në 25 përqindëshin përgjatë 3 muajve të fundit.	Shpenzimet familjare të ndara për 2.
<b>Banimi</b>	Shpenzimet e raportuara nga familjet në 25 përqindëshin përgjatë 3 muajve të fundit plus qeraja.	Duke marrë parasysh që kjo është kategoria e dytë më e madhe e shpenzimeve për të gjitha ekonomitë familjare në ABEF, e kemi pjesëtuar me 1.4 në vend të 1.6 për të siguruar një banim të dinjitetshëm.
<b>Mirëmbajtja e shtëpisë</b>	Gjysma e shpenzimeve të raportuara nga familjet në 25 përqindëshin e shpërndarjes së shpenzimeve në këtë kategori përgjatë 3 muajve të fundit.	Shpenzimet familjare të ndara për 1.6.
<b>Shëndetësia</b>	Gjysma e shpenzimeve të raportuara nga familjet në 25 përqindëshin e shpërndarjes në këtë kategori përgjatë 3 muajve të fundit.	Shpenzimet familjare të ndara për 2.

10 Të dhënat e fundit zyrtare për varfërinë nga ASK-ja janë të vitit 2017. Bazuar në ABEF të vitit 2017, 18% e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë me 1.85€ në ditë për punëtorin equivalent (ASK, 2019, f.4). Në një raport të përditësuar, UNDP (2023) vlerëson se në vitin 2023, 16% e familjeve jetonin nën kufirin e varfërisë të përcaktuar si 1.85 në ditë (fq.57). Meqë duam të sigurohemi që familja të jetojë denjësisht mbi kufirin e varfërisë, ne kemi përdorur shpenzimet e ekonomive familjare në 25 përqindëshin e distribuimit.

11 Duke marrë parasysh se 58% e shpenzimeve të të gjitha ekonomive familjare në ABEF janë në këtë kategori, i kemi pjesëtuar me 1.5 në vend të 1.6 për të siguruar një mbulim të duhur të nevojave bazike.



<b>Transporti</b>	€2 për çdo 22 ditë pune për punëtor/e. Supozojmë se fëmijët shkojnë në shkollë në këmbë.	€2 për çdo 22 ditë pune.
<b>Komunikimi</b>	€5 për secilin anëtar për muaj (Paketa Fol M) plus €16 (TV Vala Start) për tërë familjen.	Paketa Fol M dhe TV Vala Start (€5 + €16).
<b>Rekreacioni dhe kultura</b>	€4 për javë për anëtar (p.sh., 64 për muaj)	€16 për muaj.
<b>Arsimi</b>	Shpenzimet e raportuara nga familjet në 25 përqindëshin e shpërndarjes në këtë kategori përgjatë 3 muajve të fundit plus qeraja.	Shpenzimet familjare të ndara për 4.
<b>Restorantet dhe hotelet</b>	€1 për çdo ditë pune (22 ditë me orar të plotë, 14 me orar të pjesshëm) për secilin punëtor dhe €16 për anëtar për të ngrënë jashtë dy herë në muaj.	€1 për çdo ditë pune (22 ditë) dhe €6 për të ngrënë jashtë një herë në javë (psh. €24 në muaj).
<b>Të tjera</b>	Shpenzimet e raportuara nga familjet në 25 përqindëshin e shpërndarjes në këtë kategori përgjatë 3 muajve të fundit plus qeraja.	Shpenzimet familjare të ndara për 1.6.

Më tej, i kemi bërë disa adaptime shtesë. Së pari, i kemi rrumbullaksuar të gjitha vlerat në euron më të afërt. Së dyti, e kemi përfshirë një provizion për shpenzime shtesë që nuk janë përfshirë në llogaritjet tona. Këto mund të shërbejnë si një rregullim për shkak të disa gabimeve ose lëshimeve që mund të bëjmë, si siguresë nga shpenzimet e papritura, ose si para që punëtorët do të përdornin për të ndihmuar prindërit, të afërmit ose miqtë e tyre. Duke ndjekur Anker dhe Anker (2017), e kemi shtuar një margjinë prej 5% në koston e përllogaritur të jetesës.

Për më tepër, edhe pse Kosova është një vend i vogël, koston e jetesës mund të ndryshojnë nga vendi në vend. Për shembull, qeratat janë shumë më të larta në kryeqytet, në Prishtinë, sesa në qytete apo fshatra më të vegjël. Gjithashtu, koston e transportit janë më të larta për një punëtor/e që jeton në zonë rurale dhe i duhet të udhëtojë çdo ditë për të punuar në zonë urbane. Prandaj i kemi marrë parasysh diferencat e tilla të koston që bazohen në zonën e banimit - urbane dhe rurale. Konkretisht, i kemi përdorur dallimet në shpenzime për secilën kategori, në nivel agregat (pra, për të gjitha familjet në ABEF), ndërmjet familjeve që jetojnë në zona urbane dhe rurale, dhe mesatares në nivel vendi. Për të lejuar më shumë dallime, kemi marrë një qasje më konservatore duke i dyfishuar diferencat.<sup>12</sup>

12 Për shembull, nëse për një kategori, familjet urbane shpenzuan 1% më shumë se mesatarja e vendit, kemi supozuar se kjo diferencë është 2%. Tabela 2 tregon koeficientët që kemi përdorur për secilën kategori për të adaptuar pagën e jetesës për një familje standarte apo për një punëtor/e sipas zonës së banimit, pra, urbane kundrejt rurale.

Tabela 02

Koeficientët e adaptuar për zonat e banimit urban dhe rural

Kategoria	Rurale	Urbane
Ushqimi dhe pijet	0.95	1.05
Veshmbathja	0.83	1.19
Banimi	0.85 për qera 1.07 për të tjera	1.1 për qera 0.92 për të tjera
Mirëmbajtja e shtëpisë	1.04	0.94
Shëndetësia	0.98	1.01
Transporti	1.09	0.9
Komunikimi	0.99	1.01
Rekreacioni dhe kultura	0.85	1.17
Arsimi	0.96	1.09
Restorantet dhe hotelet	0.68	1.33
Të tjera	0.79	1.24

Burimi: Përlllogaritje e autorit duke përdorur të dhënat e ASK.

#### 4.4 Vlerësimi i hendekut mes pagave mbizotëruese dhe pagës së përlllogaritur të jetesës

Një nga qëllimet kryesore për vlerësimin e pagës së jetesës është krahasimi i saj me pagat tjera aktuale. Dallimi ndërmjet tyre më pas informon palët e ndryshme të interesit në lidhje me sa të përshtatshme dhe dinjitoze janë pagat e tjera në ekonomi. Kështu, pagën e jetesës e kemi shprehur si pagë mujore bruto dhe neto. Përderisa vlera neto është e barabartë me totalin e shpenzimeve të vlerësuara për një jetë bazike, por të dinjitetshme, vlera bruto merr parasysh tatimin mbi të ardhurat dhe kontributet pensionale të cilat paguhen çdo muaj. E kemi krahasuar pagën e vlerësuar të jetesës me pagën minimale dhe pagat e tjera në Kosovë për të përcaktuar madhësinë e hendeqeve ndërmjet tyre.

# 5. Vlerësimet e pagës së jetesës në Kosovë

## 5.1 Kostoja e jetesës dhe paga e jetesës

Duke ndjekur Anker dhe Anker (2017), e kemi përlllogaritur një pagë jetese në Kosovë, e cila duhet të mbulojë kostot e një jetese bazike, por të dinjitetshme. Tabela 3 tregon shpenzimet e vlerësuara për një familje standarte dhe për një punëtor/e që jeton vetëm. Përveç vlerësimit të shpenzimeve në nivel vendi, e kemi bërë dallimin mes zonave rurale dhe urbane.

Përlllogaritjet tona tregojnë se, për një familje me dy të rritur dhe dy fëmijë, shpenzimi total mujor është €1,152. Në varësi të zonës së banimit, kjo mund të variojë ndërmjet €1,091 (rurale) dhe €1,236 (urbane). Për një punëtor/e që banon vetëm, shpenzimi mujor llogaritet të jetë €720 dhe mund të variojë nga €674 deri në €775 ndërmjet zonave rurale dhe urbane, respektivisht. Këto përlllogaritje përfaqësojnë nivelet e pagës së jetesës që siguron një jetese bazike, por të dinjitetshme.

Tabela 03

Shpenzimet e jetesës për një familje dhe një punëtor që jeton vetëm

Shpenzimet e familjes (në Euro, mujore)	Familja standarte			Një punëtor/e		
	Gjithë vendi	Rurale	Urbane	Gjithë vendi	Rurale	Urbane
Ushqimi dhe pijet	274	261	288	183	174	192
Veshmbathja	84	70	100	42	35	50
Banimit	356	331	369	274	243	293
Mirëmbajtja e shtëpisë	32	33	30	20	21	19
Shëndetësia	39	38	39	20	20	20
Transporti	72	108	64	44	66	39
Komunikimi	36	36	36	21	21	21
Rekreacioni dhe kultura	64	54	75	16	14	19
Arsimi	40	38	43	10	10	11
Restorantet dhe hotelet	84	57	112	46	31	61
Të tjera	16	13	20	10	8	12
5% shtesë	55	52	59	34	32	37
<b>Gjithsej</b>	<b>1,152</b>	<b>1,091</b>	<b>1,236</b>	<b>720</b>	<b>674</b>	<b>775</b>

Burimi: Përlllogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkruara në Sektorin 3.

## NJË PAGË JETESË PËR PUNËTORËT NË KOSOVË:

Përveç mbulimit të të gjitha shpenzimeve ditore, paga e jetesës duhet të jetë e mjaftueshme duke marrë parasysh zbritjet nga paga. Në Kosovë këto zbritje përbëhen nga kontributet pensionale dhe tatimi në të ardhura. Tabela 4 tregon pagën e jetesës në terma bruto dhe neto.

Për një familje standarte, kemi supozuar se partneri i parë punon me orar të plotë, ndërsa partneri i dytë punon 3 ditë në javë për një proporcion ekuivalent të pagës së jetesës. Kështu, kemi vlerësuar pagën ekuivalente të jetesës me orar të plotë për një familje prej katër anëtarësh të jetë €1,295 bruto (€1,152 € neto). Këto vlera variojnë nga €1,224 bruto (€1,091 neto) në €1,394 bruto (€1,236 neto) ndërmjet zonave rurale dhe urbane. Nga ana tjetër, për një punëtor, kemi vlerësuar se paga e jetesës duhet të jetë €816 bruto (€720 neto), dhe mund të variojë nga €762 bruto (€674 neto) në €880 bruto (€775 neto) në varësi të zonës së banimit.

**Tabela 04** Paga e jetesës në terma bruto dhe neto

Shpenzimet e familjes (në EURO, mujore)	Familja standarte			Një punëtor/e		
	Gjithë vendi	Rurale	Urbane	Gjithë vendi	Rurale	Urbane
<b>Partneri I</b>						
Të hyrat bruto	816	762	880	816	762	880
Zbritjet në pagë	96	88	105	96	88	105
Të hyrat neto	720	674	775	720	674	775
<b>Partneri II</b>						
Të hyrat bruto	479	462	513	-	-	-
Zbritjet në pagë	48	45	52	-	-	-
Të hyrat neto	432	417	461	-	-	-
<b>Gjithsej (bruto)</b>	1,295	1,224	1,394	816	762	880
<b>Gjithsej (neto)</b>	1,152	1,091	1,236	720	674	775

Burimi: Përlllogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkruara në Sektorin 3.

## 5.2 Përcaktimi i hendeqeve mes pagave të tjera dhe pagës së jetesës

### 5.2.1 Hendeku mes pagës minimale dhe pagës së jetesës

Siç shpjeguar në Sektorin 2, ndër arsyt kryesore për përllogaritjen e pagës së jetesës është përcaktimi i dallimit me pagat tjera aktuale në ekonomi. Sërish, ky informacion është i nevojshëm për informimin e politikave që hartohen nga qeveria dhe palët e tjera të interesit, në mënyrë që të sigurohen nivelet e duhura të pagës minimale. Tabela 5 paraqet një krahasim ndërmjet niveleve aktuale të pagës minimale (€130 për punëtorët nën 35 vjeç dhe €170 për punëtorët mbi 35 vjeç), pagës minimale potenciale (€264)<sup>13</sup> dhe pagës së vlerësuar të jetesës.

Për një familje standarte, kemi supozuar se të dy të rriturit marrin nga një pagë minimale. Nëse janë nën 35 vjeç, atëherë do të fitonin vetëm 20.1% të pagës bruto të jetesës ose 21.1% të pagës neto të jetesës. Nëse janë mbi 35 vjeç, atëherë do të fitonin vetëm 26.2% të pagës bruto të jetesës ose 27.5% të pagës neto të jetesës. Nëse paga minimale rritet në €264, do të ishte një rritje e konsiderueshme në krahasim me nivelet aktuale të pagës minimale, por megjithatë do të mbulonte vetëm 40.8% të pagës bruto të jetesës ose 43.4% të pagës neto të jetesës.

Për një punëtor që është nën 35 vjeç, fitimi i një page minimale do të ishte ekuivalent me vetëm 15.9% të pagës bruto të jetesës ose 16.9% të pagës neto të jetesës. Një punëtor mbi 35 vjeç do të fitonte vetëm 20.8% të pagës bruto të jetesës ose 22% të pagës neto të jetesës. Nëse paga e re minimale zbatohet, atëherë një punëtor do të fitonte ende vetëm 32.3% të pagës bruto të jetesës ose 34.7% të pagës neto të jetesës.

Tabela 05

Krahasimi i pagës minimale me atë të jetesës

Paga minimale	Familja standarte			Një punëtor/e		
	Nën 35	Mbi 35	Potenciale	Nën 35	Mbi 35	Potenciale
Bruto	260	340	528	130	170	264
Neto	244	316	500	122	158	250

Paga e jetesës	E përllogaritur		E përllogaritur	
Bruto	1,295		816	
Neto	1,152		720	

Paga minimale / paga e jetesës	Nën 35	Mbi 35	E propozuar	Nën 35	Mbi 35	E propozuar
Bruto	20.1%	26.2%	40.8%	15.9%	20.8%	32.3%
Neto	21.1%	27.5%	43.4%	16.9%	22.0%	34.7%

Burimi: Përllogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkruara në Sektorin 3.

13 Ne i referohemi kësaj si 'potenciale' sepse nuk është zbatuar ende.


## NJË PAGË JETESË PËR PUNËTORËT NË KOSOVË:

Figura 2 paraqet dallimin midis niveleve të ndryshme të pagës minimale dhe pagës së vlerësuar të jetesës. Hendeku llogaritet duke zbritur pagën minimale nga paga e jetesës, ndërsa proporcioni llogaritet duke pjesëtuar pagën minimale me pagën e jetesës (si në Tabelën 5). Një familjeje prej dy punëtorësh nën 35 vjeç, ku të dy marrin pagë minimale, do t'i duheshin edhe €1,035 për ta arriturin nivelin e pagës së jetesës. Një familjeje prej dy punëtorësh mbi 35 vjeç, ku të dy marrin pagën minimale, do t'i duheshin edhe €955 për ta arritur nivelin e pagës minimale. Me pagën e re minimale të mundshme, ata sërish do të merrnin €767 më pak krahasuar me pagën e jetesës. Me fjalë të tjera, pavarësisht nga niveli i pagës minimale, ata do të ishin dukshëm shumë të varfër.

Një punëtori/eje nën 35 vjeç që merr pagë minimale do t'i duheshin €686 shtesë për të arritur nivelin e pagës së jetesës, ndërsa partnerit të tij ose saj mbi 35 vjeç do t'i duheshin €646. Edhe nëse zbatohet paga e re minimale, punëtorit/es do t'i duheshin €552 për të jetuar një jetë bazike por të dinjitetshme në Kosovë.

Prandaj përfundojmë se nivelet aktuale të pagës minimale janë dukshëm nën një pagë jetese. Dhe, megjithëse paga e re minimale do të ishte një rritje e konsiderueshme nga nivelet aktuale, ajo do të ishte ende nën nivelin e një page jetese. Gjithashtu vërejmë se diferencat mes pagave bruto dhe neto reflektojnë fuqinë e pamjaftueshme rishpërndarëse të skemës aktuale të tatimit mbi të ardhurat.<sup>14</sup>

**Figura 02** Hendeku mes pagës minimale dhe pagës së vlerësuar të jetesës



Burimi: Përlllogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkuara në Sektorin 3.

<sup>14</sup> Jakurti et al. (2021) gjejnë që skema aktuale e tatimit mbi të ardhurat ka progresivitet të pamjaftueshëm dhe rrjedhimisht fuqi të ulët rishpërndarëse.

## 5.2.2 Sektori publik kundrejt atij privat

Shumica e punëtorëve në Kosovë fitojnë mbi pagën minimale. Pra, përveç krahasimit me pagën minimale, ne kemi përcaktuar edhe hendekun mes pagave të tjera dhe pagës së përlllogaritur të jetesës. Për shkak të palëve të ndryshme të interesit (p.sh., qeveria ose bizneset) që përcaktojnë pagat në sektorë të ndryshëm, kemi bërë dallimin mes sektorit publik dhe atij privat. Tabela 6 paraqet krahasimin e pagave mesatare dhe të medianës sipas llojit të ndërmarrjeve në janar dhe shkurt 2024.<sup>15</sup>

Në sektorin publik kemi bërë dallimin mes administratës publike, ku 22.2% e të gjithë punëtorëve janë të punësuar dhe ku pagat caktohen nga pushteti qendror, dhe ndërmarrjeve publike, të cilat e kanë autoritetin t'i përcaktojnë vetë pagat e tyre. Në sektorin privat kemi bërë dallimin mes bizneseve individuale, të cilat punësojnë 12.2% e të gjithë punëtorëve, shoqërive me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.), të cilat përbëjnë punëdhënësin më të madh me 50.1% të punëtorëve, dhe shoqërive aksionare (SH.A.), të cilat punësojnë 10.1% të punëtorëve.

Pavarësisht nga lloji i ndërmarrjes, të gjitha pagat mesatare dhe mediana e pagave janë nën pagën e përlllogaritur të jetesës. Në çdo rast, mediana e pagave është më e ulët se paga mesatare, prandaj hendeku i saj me pagën e përlllogaritur të jetesës, siç paraqitet në figurën 3, është më i madh. Në përgjithësi, hendeku në sektorin publik është më i vogël sesa ai në sektorin privat. Një punëtor/e në administratën publike që merr një pagë mesatare, i bie të marrë 91.6% të pagës së jetesës, që është proporcioni më i lartë ndërmjet pagave mesatare në të gjitha llojet e ndërmarrjeve. Gjysma e punëtorëve të punësuar në biznese individuale, që punësojnë 12.1% të të gjithë punëtorëve në Kosovë, në rastin më të mirë, fitojnë më pak se 1/3-tën e pagës sonë të përlllogaritur. Në SH.P.K., ku është i punësuar çdo i dyti punëtor në Kosovë, paga mesatare bruto është vetëm 50.3% e pagës së jetesës. Me fjalë të tjera, ¼ e punëtorëve në Kosovë fitojnë një pagë që është nën gjysmën e pagës sonë të përlllogaritur të jetesës.

15 Tabela A.1 në Shtojcën A tregon të njëjtat përlllogaritje duke përdorur pagat nga viti 2023. Rezultatet janë shumë të ngjashme. Në të gjitha këto raste, të dhënat për paga merren nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe përfshijnë të gjitha pagat e administruara përmes tyre. Kjo rezulton në dy implikime për rezultatet tona. Së pari, ne jemi duke krahasuar pagën tonë të jetesës me pagat e regjistruara vetëm në ekonominë formale. Kjo e përfshijon ekonominë joformale e cila mbetet shqetësuese në Kosovë. Së dyti, ATK nuk ofron informacion publik që bën dallimin mes pagave të fituara nga punëtorët me orar të plotë kundrejt atyre me orar të pjesshëm. Megjithatë, ky nuk duhet të jetë një shqetësim i madh pasi, bazuar në të dhënat më të fundit të disponueshme publikisht, vetëm rreth 6.4% e punëtorëve ishin të punësuar me kohë të pjesshme në tremujorin e parë të 2023 (ASK, 2024, f.20).

Tabela 06

Krahasimi i pagave në sektorin publik kundrejt atij privat dhe paga e vlerësuar e jetesës

Proporcioni i punësimit	Sektori publik				Sektori privat	
	Administrata publike	Ndërmarrjet publike		Biznes individual	SH.P.K.	SH.A.
	22.2%	0.2%		12.2%	50.1%	10.1%

Pagat	Sektori publik				Sektori privat					
	Administrata publike		Ndërmarrjet publike		Biznes individual		SH.P.K.		SH.A.	
	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana
Bruto	747	631	692	685	295	250	571	411	664	546
Neto	661	561	614	608	271	231	511	372	590	489


Pagat/Paga e jetesës	Sektori publik				Sektori privat					
	Administrata publike		Ndërmarrjet publike		Biznes individual		SH.P.K.		SH.A.	
	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana
Bruto	91.6%	77.3%	84.8%	84.0%	36.2%	30.6%	70.0%	50.3%	81.3%	66.9%
Neto	91.8%	77.9%	85.3%	84.4%	37.7%	32.1%	70.9%	51.7%	81.9%	67.9%

Shënim: Të dhënat nga janari dhe shkurti i 2024. SH.P.K. nënkupton shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. SH.A. do të thotë shoqëri aksionare. Mesatarja mujore e punëtorëve në janar dhe shkurt 2024 ishte 372,120. Sektorët e listuar këtu përbëjnë rreth 94.8% të të gjithë punëtorëve.

Burimi: Përlllogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkruara në Sektorin 3.




**Figura 03** Hendeku midis pagave në sektorin publik kundrejt atij privat dhe pagës së përllogaritur të jetesës



Burimi: Përllogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkruara në Sektorin 3.


Një pyetje tjetër interesante që mund të bëjmë është: sa nga pagat aktuale janë në nivelin e pagës së jetesës që ne kemi përllogaritur? Siç tregohet në figurën 4, në shkurt të 2024-tës, vetëm 1 në 5 paga mund të konsiderohet si pagë jetese. Ka disa dallime të dukshme ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, siç paraqitet në figurën 5. Për shembull, në administratën publike, ku shumica e punëtorëve në sektorin publik janë të punësuar, 3 nga 10 paga mund të konsiderohen si paga jetese. Në ndërmarrjet publike, çdo e treta pagë mund të konsiderohet pagë jetese. Në sektorin privat, pjesa e pagave që mund të konsiderohet një pagë jetese është shumë më e vogël – 3 në 100 brenda bizneseve individuale, 1 në 5 në SH.P.K. dhe 3 në 10 në SH.A.



Burimi: Përllogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkruara në Sektorin 3

FIGURA 05

Përqindja e pagave që mund të konsiderohet një pagë jetese në sektorin publik ndaj atij privat



Burimi: Përlogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkruara në Sektorin 3.

Deri më tani kemi bërë dallime ndërmjet pagave dhe llojeve të ndryshme të ndërmarrjeve, por jo punëtorëve. Në tabelën 7, kemi kryer një analizë të ngjashme me tabelën 6, por duke bërë dallimin mes grave dhe burrave. Megjithatë krahasimi duke përdorur medianën e pagës është më informues, këto të dhëna nuk janë të disponueshme publikisht. Kështu, ne kemi përdorur pagat mesatare sipas gjinisë dhe llojit të ndërmarrjes nga shkurti i 2024-tës.

Përsëri, të gjitha pagat mesatare për të dyja gjinitë janë nën pagën e jetesës që ne kemi vlerësuar. Megjithatë, për shkak të pabarazisë në paga, pagat mesatare të burrave janë më afër një page jetese sesa ato të grave. Figura 6 paraqet hendekun për të dyja gjinitë. Edhe në administratën publike, ku pagat mesatare janë më të afërta me pagën tonë të përlogarit të jetesës, ka dallime të konsiderueshme midis hendekut mes pagave të fituara nga gratë dhe burrat. Përderisa paga mesatare e burrave në administratën publike do të duhej të rritej vetëm me €32 për të arritur nivelin e pagës së jetesës, për gratë rritja do të duhej të ishte pothuajse 4 herë më e madhe (€125).

Tabela 07

Krahasimi i pagave në sektorin publik kundrejt atij privat dhe paga e vlerësuar e jetesës sipas gjinisë

## Proporcioni i punësimit

Sektori publik						
Gratë			Burrat			
Administrata Publike		Ndërmarrje Publike		Administrata Publike		Ndërmarrje Publike
10.2%		0.1%		12.0%		0.2%

Sektori privat						
Biznes Individual		SH.P.K.	SH.A.	Biznes Individual		SH.A.
4.7%		18.6%	2.5%	7.2%		30.4%
				7.2%		7.6%

## Paga mesatare

Sektori publik						
Gratë			Burrat			
Administrata Publike		Ndërmarrje Publike		Administrata Publike		Ndërmarrje Publike
Bruto	691	604	785	714		
Neto	613	536	696	631		

Sektori privat						
Biznes Individual		SH.P.K.	SH.A.	Biznes Individual		SH.A.
Bruto	313	512	672	346		648
Neto	288	461	597	316		578

## Paga mesatare / paga e jetesës

Sektori publik						
Administrata Publike		Ndërmarrje Publike		Administrata Publike		Ndërmarrje Publike
Bruto	84.6%	74.0%	96.1%	87.5%		
Neto	85.1%	74.4%	96.6%	87.6%		


Sektori privat						
Biznes Individual		SH.P.K.	SH.A.	Biznes Individual		SH.A.
Bruto	38.4%	62.7%	82.3%	42.4%		79.4%
Neto	39.9%	64.0%	82.8%	43.9%		80.3%

Shënim: Të dhënat nga shkurti i 2024. SH.P.K. është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. SH.A. do të thotë shoqëri aksionare. Punësimi total është 372,528. Sektorët e përfshirë këtu përbëjnë 93.5% të punësimit total.

Burimi: Përlogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkruara në Sektorin 3.

Figura 06

Hendeku mes pagave në sektorin publik kundrejt atij privat dhe pagës së vlerësuar të jetesës sipas gjinisë



Burimi: Përlllogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkruara në Sektorin 3.

### 5.2.3 Ndryshimet ndërmjet sektorëve në bazë të aktivitetit ekonomik

Tani, në vend se t'i kemi të dhënat për lloje të ndërmarrjeve i analizojmë ato për sektorë në bazë të aktivitetit ekonomik. Figura 7 paraqet hendekun mes pagës mesatare të fituar nga gratë dhe burrat në secilin sektor në bazë të aktivitetit ekonomik.<sup>16</sup> Mund ta shohim se janë vetëm tre sektorë ekonomikë, respektivisht "Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar", "Informacioni dhe komunikimi" dhe "Aktivitete të organizatave dhe organeve ekstraterritoriale", në të cilët paga mesatare për të dyja gjinitë e tejkalon pagën tonë të përlllogaritur të jetesës. Ndërsa në sektorin "Veprimtaritë financiare dhe sigurimet" dhe "Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe punës sociale," vetëm paga mesatare e burrave e tejkalon pagën e jetesës.


Paga mesatare në "Tregti me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave", ku çdo i pesti punëtor është i punësuar (9.7% gra, 12.2% burra), arrin vetëm në 53.6% dhe 71.7% të pagës së jetesës, për gra dhe burra, respektivisht. Me fjalë të tjera, paga mesatare do të duhej të rritet me €378 për gratë dhe €267 për burrat në mënyrë që të arrijë nivelin e pagës së jetesës.

Po kështu, në "Industri përpunuese", e cila renditet e treta për nga pesha e punësimit, paga mesatare e grave është vetëm 53.5% e pagës së jetesës, ndërsa e burrave është 69%. Në terma absolutë, paga mesatare e grave në këtë sektor do të duhej të rritej për €379 dhe e burrave për €253, në mënyrë që të barazohet me pagën e jetesës që ne kemi përlllogaritur.

16 Një analizë e ngjashme si në tabelën 5, por për secilin sektor në bazë të aktivitetit ekonomik, është paraqitur në tabelën A.2 në shtojcën A.

Figura 07

Hendeku mes pagës mesatare dhe pagës së jetesës në sektorët ekonomikë sipas gjinisë



Burimi: Përlogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkuara në Sektorin 3.

## 5.2.4 Dallimet në moshë dhe gjini

Duke pasur parasysh se popullsia e Kosovës është relativisht e re në krahasim me vendet e tjera evropiane, përveç gjinisë, është e rëndësishme të analizohen pagat e marra nga punëtorët në grupmosha të ndryshme. Tabela 8 paraqet një krahasim të pagave mesatare në grupmosha të ndryshme dhe figura 8 tregon dallimet për çdo grupmoshë sipas gjinisë. Në përgjithësi, ne vërejmë dallimet më të gjera tek ekstremet: tek të rinjtë dhe tek të moshuarit.

Megjithëse të moshuarit e moshës 65+ përbëjnë vetëm 4.1% të punësimit total, paga mesatare e tyre është më e ulëta, prandaj hendeku me pagën e jetesës që ne kemi vlerësuar është më i madhi. Në këtë grupmoshë, paga mesatare do të duhej të rritet për €531 për gratë dhe për €492 për burrat në mënyrë që të arrijë nivelin e pagës së jetesës.

Të rinjtë e moshës 15-24 vjeç përbëjnë 15.9% të punëtorëve, por është grupi i dytë paga mesatare e të cilit ka diferencën më të madhe me pagën e jetesës. Paga mesatare e grave të reja do të duhej të rritej për €363 dhe e djemve të rinj për €322 në mënyrë që të barazohet me pagën e jetesës.

Tabela 08

Krahasimi i pagave mesatare të grupmoshave të ndryshme sipas gjinisë

Proporcioni i punësimit	Gratë sipas grupmoshave					
	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
	7.1%	10.7%	9.0%	6.9%	3.9%	0.9%

Burrat sipas grupmoshave						
	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
	8.8%	14.9%	13.7%	11.0%	8.6%	3.2%

Paga mesatare	Gratë sipas grupmoshave					
	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
Bruto	453	595	615	588	636	285
Neto	407	529	546	523	565	270

Burrat sipas grupmoshave						
	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
Bruto	494	654	700	746	689	324
Neto	442	578	617	658	609	305


Paga mesatare / paga e jetesës	Gratë sipas grupmoshave					
	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
Bruto	55.5%	72.9%	75.4%	72.1%	78.0%	35.0%
Neto	56.5%	73.4%	75.8%	72.6%	78.4%	37.5%

Burrat sipas grupmoshave						
	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
Bruto	60.5%	80.2%	85.8%	91.4%	84.4%	39.7%
Neto	61.3%	80.3%	85.7%	91.4%	84.6%	42.3%

Shënim: Të dhënat nga shkurti 2024. Punësimi total është 372,528. Tabela tregon informacion për 98.7% të punësimit pasi nuk ka informacion për gjininë apo grupmoshën për 1.3% të mbetur.

Burimi: Përlogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkruara në Sektorin 3.

**Figura 08** Hendeku mes pagave mesatare dhe pagës së jetesës në grupmosha sipas gjinisë



Burimi: Përlogaritjet e autorit duke përdorur të dhëna nga ABEF 2022 dhe ATK (2024).

## 6. Përfundimi

Një pagë jetese siguron që punëtorët dhe familjet e tyre të mund të mbulojnë të gjitha shpenzimet për një jetë bazike, por të dinjitetshme. Ndonëse koncepti nuk është i ri, ka një ringjallje të interesit për përlogaritjen e pagës së jetesës në vende dhe kontekste të ndryshme zhvillimi. Përlogaritje të tilla mund t'i informojnë politikat që palët e ndryshme të interesit, si qeveria, bizneset, sindikatat dhe OJQ-të, hartojnë.

Duke ndjekur metodologjinë e propozuar nga Anker dhe Anker (2017), ne kemi bërë përlogaritjet e para të pagës së jetesës në Kosovë. Për një familje standarte, kemi supozuar se partneri i parë punon me orar të plotë ndërsa i dyti punon 3 ditë në javë për një përqindje ekuivalente të pagës së jetesës. Kështu, për një jetesë bazë, por të dinjitetshme, paga e jetesës ekuivalente me orar të plotë për një familje prej katër anëtarësh përlogaritet të jetë €1,295 bruto (€1,152 neto). Këto vlera ndryshojnë nga €1,224 bruto (€1,091 neto) në €1,394 bruto (€1,236 neto) midis zonave rurale dhe urbane.

Për një punëtor/e që jeton vetëm, nga ana tjetër, paga e jetesës vlerësohet të jetë €816 bruto (€720 neto). Kjo mund të variojë nga €762 bruto (€674 neto) në €880 bruto (€775 neto) në varësi të zonës së banimit.

Hendeku mes pagës minimale dhe pagës së jetesës që ne kemi përlogaritur tregon se punëtorët që marrin një pagë minimale nuk janë në gjendje t'i mbulojnë nevojat bazike të jetës. Dhe, megjithëse paga e re minimale do të kishte një rritje të konsiderueshme nga nivelet aktuale, ajo do të ishte ende nën një page jetese.

Ne e kemi gjetur se vetëm 1 në 5 paga në Kosovë mund të konsiderohet si pagë jetese. Pavarësisht nga lloji i ndërmarrjes, qoftë ai publik apo privat, të gjitha pagat mesatare dhe medianat e tyre janë nën pagën e përlogaritur të jetesës. Në përgjithësi, hendeku në sektorin publik është më i vogël se ai në sektorin privat.

Për shkak të pabarazisë në paga që gjendet edhe në sektorë të tillë si administrata publike, ku si burrat ashtu edhe gratë paguhen mesatarisht me një pagë më të lartë se në sektorin privat, paga mesatare e burrave është më afër arritjes së nivelit të pagës së jetesës sesa ajo e grave. Përderisa paga mesatare e burrave në administratën publike do të duhej të rritet për vetëm €32 për të arritur nivelin e pagës së jetesës, për gratë rritja do të duhej të ishte pothuajse 4 herë më e madhe (€125).

Ne e kemi gjetur se vetëm në tre sektorë të ndarë në bazë të aktivitetit ekonomik, respektivisht "Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar", "Informacioni dhe komunikimi" dhe "Aktivitete të organizatave dhe organeve ekstraterritoriale", paga mesatare për të dyja gjinitë tejkalon pagën tonë të përlogaritur të jetesës. Ndërsa në sektorin "Veprimtaritë financiare dhe sigurimet" dhe "Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe punës sociale" vetëm paga mesatare e burrave e tejkalon pagën e jetesës.

Në përgjithësi, kemi vërejtur hendeqet më të gjera të ekstremet: tek të rinjtë dhe të moshuarit. Për ata të moshës 65+, paga mesatare do të duhej të rritet me €531 për gratë dhe €492 për burrat në mënyrë që të arrijë nivelin e pagës së jetesës. Për ata nga moshë 18 deri në 24 vjeç, paga mesatare do të duhej të rritet me €363 për gratë dhe me €322 për burrat në mënyrë që të barazohej me një pagë jetese.

Kështu, vijmë në përfundimin se dallime të tilla të mëdha si këto kërkojnë veprime urgjente nga qeveria për të rritur pagën minimale, nga bizneset për të rritur pagat në sektorët e tyre ekonomikë, nga sindikatat për tu organizuar rreth kauzës për një pagë jetese dhe nga OJQ-të dhe organizata tjera ndërkombëtare që të hartojnë politika që synojnë zhdukjen e varfërisë së punës.



# Bibliografia

- Anker, R. (2011). Përlllogaritja e një page jetese: Një rishikim metodologjik. Gjenevë: Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP).
- Anker, R., & Anker, M. (2017). *Pagat e jetesës nëpër botë: Manual për përlllogaritje*. Cheltenham: Publikimet Edward Elgar.
- ASK. (2019). *Varfëria e konsumit në Republikën e Kosovës*. Prishtinë: Banka Botërore dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).
- ASK. (2023a). *Anketa e Fuqisë Punëtore TM1 2022*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).
- ASK. (2023b). *Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2022*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).
- ASK. (2024). *Anketa e Fuqisë Punëtore TM1 2023*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).
- ASK. (2024a). *CPI-HICP sipas grupeve kryesore të COICOP, 2002M05 - 2024M02*. Marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): [https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/ASKdata\\_\\_Prices\\_\\_Consumer%20Price%20Index\\_\\_Monthly%20indicators/cpi08.px/](https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/ASKdata__Prices__Consumer%20Price%20Index__Monthly%20indicators/cpi08.px/)
- ASK. (2024b). *Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit, Shkurt 2024*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).
- ATK. (2024). *Open Data*. Marrë nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK): <https://www.atk-ks.org/en/open-data/>
- Banka Botërore. (2024). *Treguesit e Zhvillimit Botëror*. Marrë nga Banka Botërore: <https://databank.worldbank.org/source/world-development-indicators>
- Bongaarts, J. (2001, Nëntor). *Madhësia dhe përbërja e familjes në botën në zhvillim në vitet 1990*. *Population studies*, 55(3), 263-279.
- Drevinja, M., & Ymeri, V. (2022). *Kush kujdeset? Puna e kujdesit pa pagesë në Kosovë*. Prishtinë: Instituti per Politika Sociale Musine Kokalari.
- GAP. (2024). *Prirja për të emigruar nga Kosova pas liberalizimit të vizave: ndikimi në fuqinë punëtore*. Prishtinë: Instituti GAP.
- Guzi, M. (2021). *Kostoja e jetesës dhe pagat minimale në vendet e BE-27*. Bratislava: E majta ne Parlamentin Europian.
- Guzi, M., & Kahanec, M. (2018). *Përlllogaritja e pagës së jetesës në botë*. Amsterdam: WageIndicator Foundation.
- Jakurti, E., Dobranja, D., Vllasaliu, D., Bahtiri, L., & Veliu, M. (2021). *Perspektiva e përgjithshme: Agjenda progresive ekonomike për Kosovën*. Prishtinë: Friedrich Ebert Stiftung (Kosova).
- Kerrissey, J., & Meyers, N. (2021). *Sindikatat e sektorit-publik si institucione të barazisë: Raca, gjinia dhe të hyrat*. *ILR Review*, 75(5).
- Kombet e Bashkuara. (1948). *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*. Marrë nga Kombet e Bashkuara: <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>
- Neumark, D. (2004). *Pagat e jetesës: Mbrojtje për ose mbrojtje nga punëtorët me paga të ulëta*. *ILR Review*, 58(1).
- ONP. (1919). *Kushetuta e ONP*. Marrë nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) : [https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=1000:62:0::NO:62:P62\\_LIST\\_ENTRIE\\_ID:2453907:NO](https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=1000:62:0::NO:62:P62_LIST_ENTRIE_ID:2453907:NO)
- Telekomi i Kosovës. (2024, 3 20). *Pakot TV*. Marrë nga Telekomi i Kosovës: <https://kosovotelecom.com/privat/ne-shtepi/pakot-tv/>
- Trafiku Urban. (2024). *Çmimet*. Marre nga Trafiku Urban Prishtinë: <https://trafikurban-pr.com/cmimet>
- UNDP. (2023). *Eksplorimi i dinamikës së varfërisë së familjeve përballë inflacionit: Dëshmi nga një anketë*. Prishtinë: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (Kosova).

# Shtojca A

Tabela A.1

Krahasimi i pagave në sektorin publik kundrejt atij privat dhe pagës së vlerësuar të jetesës (2023)

Proportioni i punësimit	Sektori publik				Sektori privat					
	Administrata publike		Ndërmarrje publike		Biznes Individual		SH.P.K.		SH.A.	
	21.7%		0.2%		13.2%		50.9%		9.8%	

Pagat	Sektori publik				Sektori privat					
	Administrata publike		Ndërmarrje publike		Biznes Individual		SH.P.K.		SH.A.	
	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana
Bruto	741	625	686	677	292	250	567	401	659	543
Neto	656	556	609	601	268	231	507	364	586	487

Pagat / Paga e jetesës	Sektori publik				Sektori privat					
	Administrata publike		Ndërmarrje publike		Biznes Individual		SH.P.K.		SH.A.	
	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana
Bruto	90.8%	76.5%	84.1%	82.9%	35.8%	30.6%	69.5%	49.2%	80.8%	66.6%
Neto	91.0%	77.2%	84.5%	83.4%	37.2%	32.1%	70.4%	50.5%	81.4%	67.6%

Shënim: Të dhënat e vitit 2023. Në vitin 2023, numri mesatar mujor i punëtorëve ishte 377,099. Sektorët e listuar këtu përbëjnë rreth 95.9% të të gjithë punëtorëve.

Burimi: Përlllogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkruara në Sektorin 3.

Tabela A.2

Krahasimi i pagës mesatare dhe pagës së përlogaritur të jetesës në sektorët ekonomikë sipas gjinisë

Sektori	Proporcioni i punësimit		Paga mesatare				Paga mesatare/ Paga e jetesës			
	Gratë	Burrat	Gratë		Burrat		Gratë		Burrat	
			Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	0.3%	0.4%	324	296	435	393	39.8%	41.2%	53.3%	54.5%
Industria nxjerrëse (Minierat dhe xehroret)	0.1%	1.0%	544	486	648	577	66.7%	67.4%	79.4%	80.1%
Industria përpunuese	7.5%	3.3%	437	396	563	505	53.5%	55.0%	69.0%	70.2%
Energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	0.3%	1.7%	1,019	893	1,076	943	124.9%	124.0%	131.9%	131.0%
Furnizimi me ujë; trajtimi dhe menaxhimi i mbeturinave	0.2%	1.2%	563	503	595	532	69.0%	69.8%	72.9%	73.9%
Ndërtimtaria	0.9%	4.9%	468	422	549	493	57.4%	58.6%	67.3%	68.4%
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave	9.7%	12.2%	438	396	585	524	53.6%	55.0%	71.7%	72.8%
Transporti dhe maganizimi	0.4%	1.8%	469	421	483	434	57.4%	58.4%	59.1%	60.3%
Aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor	1.6%	3.5%	342	313	383	348	42.0%	43.4%	47.0%	48.3%
Informacioni dhe komunikimi	1.5%	2.6%	821	730	1,059	933	100.7%	101.3%	129.8%	129.5%
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	2.0%	3.8%	765	676	936	822	93.7%	93.9%	114.7%	114.2%
Aktivitetet e pasurive të paluajtshme	0.2%	0.1%	475	427	559	500	58.2%	59.3%	68.5%	69.4%
Aktivite profesionale, shkencore dhe teknike	1.8%	1.4%	638	568	779	691	78.2%	78.9%	95.5%	96.0%
Aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse	1.9%	1.7%	575	512	681	605	70.4%	71.1%	83.4%	84.0%
Admin. publike dhe mbrojtja	10.1%	12.4%	690	612	759	674	84.5%	85.0%	93.0%	93.5%
Arsimi	1.2%	0.5%	483	435	682	607	59.1%	60.4%	83.6%	84.2%
Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	1.4%	0.5%	463	419	1,076	948	56.7%	58.1%	131.9%	131.6%
Arti, kultura and rekreacioni	0.2%	0.3%	357	324	566	506	43.7%	44.9%	69.4%	70.2%
Aktivite të tjera të shërbimit	1.5%	1.3%	600	537	703	625	73.5%	74.5%	86.1%	86.7%
Aktivitetet e amvisërive si punëdhënës	0.0%	-	264	244	-	-	32.4%	33.9%	-	-
Aktivitetet e organizatave dhe organeve ekstraterritoriale	0.2%	0.3%	1,422	1,242	1,476	1,285	174.3%	172.4%	180.9%	178.3%

Shënim: Të dhënat për shkurt 2024. Sektorët e listuar këtu përbëjnë 97.9% të punësimit. Punësimi i mbetur nuk ka ndonjë sektor të caktuar.

Burimi: Përlogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat e përshkruara në Sektorin 3.





